



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2020:143707

Datë: 26.03.2024

Numri i dokumentit: 05505045

KA.nr.493/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtari Arben Toska, në konfliktin administrativ të paditësit “Story Caffè Bar” ShPK me seli në rrugën “Safedin Xërxa” p.nr. në Gjakovë, kundër të paditurës Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, Inspektorati Sanitar me seli në Prishtinë, me objekt të konfliktit administrativ anulimi i aktit administrativ, jashtë seancës, më 26 mars 2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

Konsiderohet e tërhequr padia e paditësit A.K. pronar i “Story Caffè Bar” ShPK në Gjakovë, kundër të paditurës Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, Inspektorati Sanitar me seli në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimit AUV. Ref. 04/02-2035/2020 të datës 01.10.2020 të së paditurit.

A R S Y E T I M

Paditësi më 28.10.2020 ka paraqitur padi kundër të Paditurit, me të cilën kishte kërkuar anulimin e vendimit AUV. Ref. 04/02-2035/2020 të datës 01.10.2020 të së paditurit Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, Inspektorati Sanitar. Meqenëse paditësi nuk kishte bashkëngjitur padisë vërtetimin mbi pagesën e taksës gjyqësore, kjo gjykatë më datë përmes afishimit në tabelën e shpalljeve më 23.02.2024 i ka dorëzuar Paditësit vërejtjen për pagesën e taksës gjyqësore. Përmes asaj vërejtjeje Paditësi është paralajmëruar se nëse nuk paguhet taksa gjyqësore brenda afatit prej 15 ditëve nga dita e pranimit, atëherë gjykata do të veproj sipas nenit 253 para. 5 të LPK-së dhe nenit 5 lidhur me nenin 6 të Udhëzimit Administrativ 01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore të Këshillit Gjyqësor.

Në bazë të shkresave të lëndës gjykata konstaton se, Paditësi jo që nuk e ka paguar taksën gjyqësore brenda afatit të caktuar prej 15 ditëve, por ajo nuk është paguar as deri në ditën e marrjes së këtij aktvendimi. Kjo gjykatë gjithashtu gjeti se në shkresat e lëndës nuk ka prova, në bazë të cilave do të mund të konstatohej se plotësohen kushtet ligjore nga nenet 468 deri 473 të LPK-së për lirimin e Paditësit nga shpenzimet procedurale.

Pasojat juridike të mos pagesës së taksës gjyqësore janë të rregulluara në nenin 253 para. 5 të LPK-së, sipas të cilit *“Në qoftë se paditësi nuk e paguan taksën gjyqësore të përcaktuar për padinë as pas vërejtjes së dërguar nga gjykata, edhe pse nuk ekzistojnë konditat për lirim nga detyrimi i pagimit të taksës gjyqësore, do të konsiderohet se padia është tërhequr”*. Gjithashtu edhe neni 5 para. 5 nënpara 2 të Udhëzimit Administrativ 01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore të Këshillit Gjyqësore ka përcaktuar se *“Pala duhet ta paguajë taksën në afatin e caktuar nga gjykatësi, gjegjësisht kryetari i trupit gjykues, i cili nuk mund të jetë më i shkurtër se 15 dite. Nëse kjo taksë nuk paguhet në kohën e caktuar, gjykata zbaton procedurat e parapara, si ne vijim: (...) 5.5.2 Nëse taksa për padi, e përcaktuar sipas vlerës së kontestit në padi, nuk paguhet deri në datën përfundimtare, edhe pas pranimit të vërejtjes për pagesën e saj, në rastet kur nuk ekzistojnë kushtet për lirimin e palës nga detyrimi i pagesës, do të zbatohet neni 253 paragrafi 5 i Ligjit për Procedurën Kontestimore, ashtu që do të konstatohet se padia është tërhequr*.

Për këto arsye, gjykata e konsideron të tërhequr padinë e Paditësve dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimit.

Gjykata Komerciale e Kosovës

Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative

KA.nr.493/22

Gjyqtari

---

Arben Toska

UDHËZIMI PËR MJETIN E GODTIJES: Kundër këtij aktvendimi mund të paraqitet ankesë brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit. Ankesa në formë të shkruar dhe në ekzemplarë të mjaftueshme për gjykatën dhe secilën palë tjetër dorëzohet në këtë gjykatë, ndërsa i drejtohet Dhomës së Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale.